



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË ENERGJISË

RREGULLORE
MBI PËRCAKTIMIN E MIRATIMIN E PAGESAVE RREGULLATORE

Neni 1

Autoriteti

Rregullorja për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të gjithë të licensuarit e tregut të energjisë elektrike nga Enti Rregullator i Energjisë, është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”,

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për llogaritjen e pagesave rregullatore/të rregullimit për të gjithë të licensuarit në tregun e energjisë elektrike si një nga burimet kryesore të financimit të ERE-s, me qëllim mbulimin e kostove të aktivitetit të rregullimit .

Neni 3

Objektivi

Objektivi i kësaj rregulloreje të llogaritjes së pagesave rregullatore është të përcaktojë pagesa rregullimi të vecanta për të gjithë të licensuarit në aktivitetin e prodhimit transmetimit, shpërndarjes, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, furnizimit, tregëtimit dhe operimit të tregut të energjisë elektrike, .

Neni 4

Termet e përdorur në metodologji

Termet e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin si më poshtë:

4.1 Pagesa rregullatore – pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licensuara në sektorin e energjisë elektrike paguajnë për llogari të ERE-S për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore.

4.2 Të Licensuar – shoqëri që janë licensuar nga ERE për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, transmetimit të energjisë elektrike, shpërndarjes/ furnizimit të energjisë elektrike si dhe tregëtimit të energjisë elektrike, operimit të sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, Operimit të Tregut të energjisë elektrike.

4.3 Të ardhurat – nënkuptojnë të ardhurat vjetore të deklaruara në pasqyrat financiare të audituara referuar Standarteve të Kontabilitetit në fuqi.

Neni 5

Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

- 5.1 Kjo Rregullore është konceptuar konform nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ku parashikohet se:
- a. Burimet financiare të ERE-së përbëhen nga pagesat rregullatore, të vendosura nga ajo vetë për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike, dhe nga pagesat e licensave.
 - b. ERE-ja mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi kontabilitetin.
- 5.2 Pagesa rregullatore, në zbatim të pikës 52 të nenit 3 të Ligjit 43/2015 llogaritet dhe mbledhet mbi baza vjetore për çdo shoqëri të licensuar, pavarësisht faktit nëse në momentin e llogaritjes së kësaj pagese kompania nuk e ka filluar aktivitetin për të cilin është licensuar
- 5.3 Pagesa duhet të jetë në përpjestim të drejtë me të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licensuar.
- 5.4 Të licensuarit në zbatim të neneve 45 e 46 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe të kushteve të licensës depozitojnë në ERE deri më datë 31 Janar të vitit pasardhës pasqyra të plota për vitin e mëparshëm ushtrimor e më tej deri në datë 30 Qershor kopje të audituar të pasqyrave financiare të periudhës së mëparshme nga ku rezulton informacioni mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i licensuar që do të përdoren në llogaritjen e pagesave të rregullimit.

5.5 Pagesat rregullatore duhet të miratohen deri në 31Janar të vitit aktual.

Neni 6

Përcaktimi i pagesës rregullatore për të licencuarit në sektorin e energjisë

6.1 Pagesat rregullatore do të llogariten bazuar në peshën specifike që zënë të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës nga aktiviteti i cdo të licensuari ndaj totalit të të ardhurave të sektorit të energjisë elektrike.

6.2 Pagesa rregullatore për secilin të licensuar është e barabartë me produktin e peshës specifike të llogaritur sipas pikës 6.1 me vleftën për t'u shpërndarë, buxhetin e ERE-s (pasi të jenë zbritur pagesat fikse nga licënsimit) të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 17 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

6.3 Për shoqëritë e licensuara në aktivitetin e prodhimit, furnizimit dhe tregëtimit të energjisë elektrike që në vitin paraardhës nuk kanë pasur aktivitet, pagesa rregullatore do të jetë një shumë fikse prej 40 mijë lekësh .

6.4 Në rastet kur një shoqëri e licensuar nuk ka paraqitur pasqyrat financiare , sic parashikon neni 46 i Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, atëhere ERE do të përlllogaritë këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga Publikime Zyrtare

Neni 7

Korigjimi

ERE, me paraqitjen e një kërkesë nga të licensuarit në rast të pasaktësive të llogaritjes në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti i licensuar, rillogarit dhe korigjon pagesën rregullatore të vitit aktual në pagesën rregullatore të vitit pasardhës.

Neni 8

Njoftimi

8.1 ERE pasi përcakton pagesat rregullatore njofton të licencuarin për vlerën, afatet e pagesës për vitin ushtrimor, vëndin e kryerjes së këtyre pagesave dhe penalitetet në rast se kjo pagesë nuk kryhet në kohë.

8.2 Pagesat rregullatore depozitohen nga ERE në një llogari të veçantë , të hapur në një nga

bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi

Neni 9 Penalitetet

9.1 Në rast se i licencuari nuk bën pagesën rregullatore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

9.2 Refuzimi i paraqitjes së pasqyrave financiare në kohë ose dërgimi me vonesë i tyre përbëjnë kundravajtje administrative dhe ndëshkohen sipas pikës 1 (b) nenit 107 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

9.3 Në rast se i licensuari nuk përmbush detyrimin për kryerjen e pagesës rregullatore edhe pas masës së marrë sipas pikës 9.1. e 9.2 këtij neni, atëherë ndaj tij Bordi mund të fillojë procedurat për heqjen e licensës, siç përcaktuar në pikën 1 (c) të nenit 42 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 10 Dispozita përfundimtare

Rregullorja për përcaktimin e pagesave rregullatore për të gjithë të licensuarit e tregut të energjisë nga Enti Rregullator i Energjisë, u miratua nga Bordi i ERE me Vendimin Nr. 190, datë 23.11.2017.